

VENDIM
Nr.540, datë 7.7.2010

**PËR NGRITJEN DHE FUNKSIONIMIN E SEKRETARIATIT, PËR NDJEKJEN E
PROCEDURAVE TË ANËTARËSIMIT TË SHQIPËRISË, SI VEND ZBATUES, NË
NISMËN PËR TRANSPARENCË NË INDUSTRIJË NXJERRËSE (EITI)**

Në mbështetje të pikës 3 të nenit 102 të Kushtetutës dhe të neneve 10, pika 1, e 12, të ligjit nr.9000, datë 30.1.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ngritjen e sekretariatit për ndjekjen e procedurave të anëtarësimit të Shqipërisë, si vend zbatues, në Nismën për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse.

2. Sekretariati e ka selinë në Tiranë dhe e zhvillon veprimtarinë e tij në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

3. Sekretariati është institucion në varësi të Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe ka vulën e logon e tij.

4. Misioni i sekretariatit është realizimi i të gjithë hapave të anëtarësimit të Shqipërisë, si vend zbatues, në Nismën për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse (EITI), dhe, pas këtij anëtarësimi, përgatitja e raporteve vjetore, si vend zbatues i kësaj Nisme, në bashkëpunim me grupin ndërinstitucional të punës të Nismës për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse.

5. Detyrat dhe objektivat e sekretariatit janë:

a) Ngritja dhe mirëfunksionimi i infrastrukturës së nevojshme, në mbështetje të programit të veprimeve, të miratuar për Nismën për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse;

b) Rishikimi i bazës ligjore për të evidentuar pengesat e mundshme për zbatimin e EITI-së;

c) Ndërtimi i kapaciteteve/trajnimi i punonjësve shtetërore, i shoqërisë civile (përfshirë dhe median), i grupeve të interesit për EITI-në dhe problemet në sektorin e industrisë nxjerrëse;

ç) Hartimi i raporteve vjetore dhe i raportit të vlerësimit, auditimit të raportit dhe plotësimi i procedurave për hartimin e raportit të vlerësimit, si vend zbatues i Nismës për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse;

d) Identifikimi i burimeve të qëndrueshme të financimit për zbatimin e EITI-së dhe monitorimi i tyre;

dh) Publikimi dhe shpërndarja e raporteve në përputhje me kërkesat e EITI-së;

e) Hartimi në vazhdimësi i raporteve vjetore dhe garantimi i auditimit të tyre;

ë) Përzgjedhja dhe sigurimi i përgatitjes profesionale të personelit të nevojshëm, në mbështetje të programit të veprimit të EITI-së, në fazat e ndryshme të saj;

f) Raportimi para grupit ndërinstitucional të punës, në mënyrë periodike, për ecurinë e realizimit të veprimtarive të programit dhe të hapave të anëtarësimit.

6. Sekretariati, për të realizuar misionin dhe objektivat e tij, do të bashkëpunojë dhe do të bashkërendojë veprimtarinë e tij me grupin ndërinstitucional të punës së Nismës për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse dhe me institucione të tjera, publike dhe/ose private, me grupet e interesit, shoqërinë civile, median vendase dhe/ose të huaja.

7. Sekretariati është institucion buxhetor që financohet nga:

a) buxheti i shtetit (fonde të destinuar për programin e veprimeve të Nismës për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse , EITI);

b) burime financiare nga palë të treta, të destinuar për programin e veprimeve të Nismës për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse EITI, nga fonde të institucioneve ndërkombëtare, të shteteve të veçanta dhe të organizatave të ndryshme, në përputhje me legjislacionin në fuqi;

c) donacione të subjekteve fizike dhe/ose juridike, nga sektori privat, vendas dhe/ose i

huaj, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.

Për vitin 2010, fondet e përcaktuara në buxhetin e shtetit për institucionin e AKBN-së, për problematikën e EITI-së, do të përdoren nga ky sekretariat.

8. Sekretariati e përdor buxhetin për fondin e pagave të punonjësve dhe për shpenzime të tjera, në funksion të përmbushjes së misionit dhe të detyrave të tij.

9. Drejtuesi i sekretariatit emërohet, lirohet dhe shkarkohet nga detyra me urdhër të Kryeministrit.

10. Drejtuesi i sekretariatit përfaqëson sekretariatin në marrëdhënie me të tretët.

11. Funksionimi i sekretariatit bazohet në rregulloren e funksionimit, e cila hartohet nga strukturat e tij dhe miratohet nga Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

12. Sekretariati raporton në çdo mbledhje të grupit ndërinstitucional të punës të Nismës për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse (EITI) dhe çdo vit, në mënyrë periodike, përgatit informacion me shkrim për Kryeministrin për ecurinë e realizimit të programit të veprimeve dhe të raportit vjetor të EITI-së.

13. Procedurat e emërimit dhe të lirimit nga detyra të punonjësve të sekretariatit bëhen në përputhje me ligjin nr.8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil” dhe me aktet nënligjore në fuqi.

14. Brenda një periudhe tremujore nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, sekretariati duhet të plotësohet me numrin e duhur të punonjësve.

15. Ngarkohet Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për të siguruar mjediset e punës për punonjësit e sekretariatit.

16. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha